



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202001749/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandojmë mbledhjen e menjëhershme të kontributeve të sigurimeve shoqërore nga Shoqëria "Arturi" Sh.p.k, për periudhën 01.08.2001 deri më 30.09.2006 mbi pagën 22,500 lekë/muaj së bashku me indeksimet e bëra me VKM; për periudhën nga data 01.10.2006 deri më 31.01.2007 mbi pagën 30,000 lekë/muaj së bashku me indeksimet e bëra me VKM; për periudhën 01.02.2007-04.05.2007 sipas pagës minimale të referencës të përcaktuar në VKM Nr. 42 datë 31.01.2007 në masën 48,611 lekë/muaj dhe për periudhën 04.05.2007 deri më datë 31.12.2010 sipas pagës minimale të referencës të përcaktuar në VKM-në Nr. 285 datë 04.05.2007 në masën 150,000 lekë/muaj, duke paguar edhe diferencën e pagesave të kryera për efektet e rillogaritjes së masës së pensionit për shtetasin Y.Y, nga data e lindjes së përfitimit të pensionit, 14.06.2014 deri në ditën e ekzekutimit të vendimit nr.183 datë 19.02.2019 të Gjykatës së Apelit Tiranë.*

Drejtuar: Znj. Delina IBRAHIMAJ

Drejtoreshë e Përgjithshme e Tatimeve

TIRANË

E nderuar znj. IBRAHIMAJ,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, ka paraqitur ankesë shtetasi Y. Y, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mosmbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore nga Shoqëria “Artur” Sh.p.k .

Sipas shpjegimeve të parashtruara në ankesën e tij, shtetasi Y.Y, nga viti 2001 deri në vitin 2010 ka qenë i punësuar, me kontrate pune, në pozicionin e drejtuesit teknik, pranë Shoqërisë “Arturi” Sh.p.k. Në vitin 2011, ka konstatuar se kontributet e sigurimeve shoqërore, nuk ishin llogaritur dhe derdhur pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

Aktualisht, ai është përfitues i pensionit të pleqërisë. Bazuar në pagat dhe kontributet e derdhura, masa e pensionit të pleqërisë nuk i është llogaritur për të gjitha vitet e punës pranë atij subjekti, sepse nuk janë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat 01.08.2001- 30.09.2006; 01.10.2006 - 31.01.2007; 01.02.2007-04.05.2007; 04.05.2007 - 31.12.2010.

Pasi ka kërkuar të drejtën e tij pranë organeve tatimore dhe nuk mori asnjë përgjigje konkrete për zgjidhjen e çështjes së tij, ka ndjekur rrugën gjyqësore. Me vendimin nr.183 datë. 19.02.2019, Gjykata e Apelit, Tiranë, ka vendosur:

“..- Detyrimin e të paditurit Shoqëria “Arturi” Sh.p.k, të paguajë në favor të palës paditëse Y.Y pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë Rajonale të Tatim-Taksave, Tiranë, kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore për periudhën 01.08.2001 deri më 30.09.2006 mbi pagën 22,500 lekë/muaj së bashku me indeksimet e bëra me VKM; për periudhën nga data 01.10.2006 deri më 31.01.2007 mbi pagën 30,000 lekë/muaj së bashku me indeksimet e bëra me VKM; për periudhën 01.02.2007-04.05.2007 sipas pagës minimale të referencës të përcaktuar në VKM Nr. 42 datë 31.01.2007 në masën 48,611 lekë/muaj dhe për periudhën 04.05.2007 deri më datë 31.12.2010 sipas pagës minimale të referencës të përcaktuar në VKM-në Nr. 285 datë 04.05.2007 në masën 150,000 lekë/muaj, duke paguar edhe diferencën e pagesave të kryera për efektet e rillogaritjes së masës së pensionit për shtetasin Y.Y, nga data e lindjes së përfitimit të pensionit, 14.06.2014 deri në ditën e ekzekutimit të këtij vendimi vendimit”’.

Pas marrjes së këtij vendimi, ankuesi i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me kërkesë për ekzekutimin e vendimit të sipërcituar dhe ushtrimin e kompetencave të tyre ligjore për të mbledhur kontributet e papaguara.

Nga ana e organeve tatimore nuk pati asnjë reagim, ndërsa Instituti i Sigurimeve Shoqërore iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me një kërkesë për të realizuar mbledhjen e detyrimeve sipas periudhave të përcaktuara në vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë që në muajin Gusht 2019 është bërë një rivlerësim i detyrimeve që subjekti Shoqëria “Arturi” Sh.p.k ka ndaj shtetasit Y.Y, duke njoftuar edhe "Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë", por që atëherë nuk është kryer asnjë veprim konkret. Nisur nga ky mosveprim, ky shtetas, më datë 30.01.2020 i është drejtuar me shkresën nr.2224.prot, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, por përsëri nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare.

Shtetasi Y.Y kërkon derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga Shoqëria “Arturi”Sh.p.k në emër të tij, sepse kjo do t’i mundësojë që të marrë ato të drejta që i garanton Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji nr.7703 datë 11.05.1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, për të përfituar një masë më të lartë pensioni pleqërie.

Duke e konsideruar këtë çështje si shkelje të të drejtave të tij ligjore, ka kërkuar ndihmën e institucionit të Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Nga dokumentacioni bashkangjitur ankesës, konstatojmë si më poshtë:

- Me shkresën nr. 3897/3 datë 22.07.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me anë të së cilës ka kërkuar zgjidhjen e kërkesës së shtetasit Y.Y, duke qenë se institucioni që Ju drejtoni është institucioni i ngarkuar me ligjin nr.9136 datë 11.09.2003 “*Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë*”, ku në zbatim të nenit 3, “*Përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve*”, nenit 14 “*masat shtrenguese*” si dhe të nenit 18 “*Vlerësimi*”, të këtij ligji, është përcaktuar se janë organet tatimore që ushtrojnë përgjegjësitë përkatëse në kuptim dhe zbatim të këtij ligji.
- Me shkresën nr.14257/1 datë 05.08.2019 Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve i ka dërguar Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë shkresën e dërguar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore “*Mbi kërkesën e z.Y. Y për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore*”.

- Me shkresën nr. 39056/1 datë 20.08.2019, Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Tiranë i është drejtuar Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë, për vazhdim të procedurave të mëtejshme, pasi nga ana e asaj drejtorie ishte përfunduar procedura e rivlerësimit të subjektit Shoqëria “Arturi” Sh.p.k, në zbatim të Vendimit nr.183 datë 19.02.2019 të Gjykatës së Apelit, Tiranë.
- Me shkresën nr. 39056/2 datë 28.10.2019, Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë, i ka kthyer përgjigje Institutit të Sigurimeve Shoqërore se subjekti i sipërcituar, rezulton të jetë me detyrime të papaguara ndaj asaj drejtorie në shumën 1.873.307 lekë. Për këtë arsye, ndaj tij janë marrë të gjitha masat shtrënguese sipas ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Pavarësisht se Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë, në shkresën e saj shprehet se, ka marrë të gjitha masat shtrënguese për mospagim të detyrimeve të kontributeve shoqërore ndaj Shoqërisë “Arturi” Sh.p.k, situata në të cilin ndodhet shtetasi Y.Y, derivon nga mosveprimi i organeve tatimore për të mbledhur me forcë kontributet shoqërore nga ky subjekt, gjë që ka sjellë si pasojë mospërfitim të plotë të masës së pensionit të pleqërisë, duke penalizuar këtë shtetas.

Në analizë të akteve ligjore, që rregullojnë mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, konstatojmë se, Ligji nr. 9136 datë 11.09.2003 "*Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në nenin 3, ka përcaktuar se:

“Kontributet mbledhen nga organet tatimore për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjor”.

Pra, përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve shoqërore i takon organeve tatimore.

Për këtë arsye çmojmë se:

Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë duhet të mbledhë kontributet e detyrueshme shoqërore, në zbatim të ligjit të sipërcituar, në mënyrë që ankuesi të përfitojë atë masë pensioni që duhet të kishte përfituar që nga

momenti i lindjes së të drejtës për përfitim të pensionit të pleqërisë dhe të mos penalizohen shtetasit nga moszbatimi i tij.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka garantuar se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. *Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.*

Sa më lart, me qëllim përfitimin e plotë të pensionit të pleqërisë sipas kontributit të dhënë ndër vite të shtetasit Y.Y, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se : *“Paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË

Mbledhjen e menjëhershme të kontributeve të sigurimeve shoqërore nga Shoqëria “Arturi” Sh.p.k, për periudhën 01.08.2001 deri më 30.09.2006 mbi pagën 22,500 lekë/muaj së bashku me indeksimet e bëra me VKM; për periudhën nga data 01.10.2006 deri më datë 31.01.2007 mbi pagën 30,000 lekë/muaj së bashku me indeksimet e bëra me VKM; për periudhën 01.02.2007-04.05.2007 sipas pagës minimale të referencës të përcaktuar në VKM Nr. 42 datë 31.01.2007 në masën 48,611 lekë/muaj dhe për periudhën 04.05.2007 deri më datë 31.12.2010 sipas pagës minimale të referencës të përcaktuar në VKM-në Nr. 285 datë 04.05.2007 në masën 150,000 lekë/muaj, duke paguar edhe diferencën e pagesave të kryera për efektet e rillogaritjes së masës së pensionit për shtetasin Y.Y, nga data e lindjes së përfitimit të pensionit, 14.06.2014 deri në ditën e ekzekutimit të vendimit nr.183 datë 19.02.2019 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se; *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim...”*, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Bashkëlidhur ju dëgojmë kopje të:

- Shkresës nr. 3897/3 datë 22.07.2019 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore
- Shkresës nr. 39056/1 datë 20.08.2019 dhe nr. 39056/2 datë 28.10.2019 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R

Vilma SHURDHA

